

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria e Privatizimit te Sektoreve te S.M.E

URDHER

Nr. EA/5 Date 4.6.1999

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SH.A " PRODHIME
FARMACEUTIKE "TIRANE

Me cilesine e aksionerit te vetem, bazuar ne paragrafin e pare te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996", ne baze te nenit 152 te Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare".

Urdheroj:

1. Ne aktet e themelimit te "Prodhime Farmaceutike " Sh.A Tirane te behen ndryshimet e meposhtme :

Ne kapitalin themeltar te shoqerise " Prodhime Farmaceutike " SH.A Tirane te shtohet vlera 116.211.200 leke si rezultat I perfshirjes ne kapital te rezervave , fitimeve qe ka krijuar shoqeria gjate aktivitetit te saj dhe pakesimin e kapitalit per vleren 387.200. leke si territori rruge kalimi per shoqerine private Prodentalfarma . Kapitali themeltar behet 607.296.000 leke dhe numri I aksioneve 607.296 .

Te behen keto ndryshime ne piken 4 te aktit te themelimit dhe ne nenin 3 te statutit.

2-. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te S.M.E. -ve te beje veprimet perkatese per ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise anonime "Prodhime Farmaceutike " Tirane ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".

MINISTRI
YLLI

